

## KËRKIME GJUHËSORE

---

Blerta XHEKO

### **RRETH VARGUT FOLJE – EMËR VEPRIMI – EMËR VEPRUESI – MBIEMËR PREJPJESOR NË SHQIPE DHE NË ANGLISHTE**

Shqipja, si asnjëherë tjetër më parë, i ka shpeshuar dhe i ka zgjeruar shumë lidhjet e kontaktet me anglishten, për arsye tashmë shumë të njohura, veçanërisht, sepse anglishtja është gjuha kryesore në komunikimin mbarëbotëror. Në fushën e gjuhësisë kjo dukuri është shoqëruar me studimin e dukurive të shumta që dalin nga këto lidhje dhe kontakte. Nën sistemi gjuhësor i shqipes që i reflekton më shumë proceset e ndryshme është leksiku. Ky leksik, si i shqipes, ashtu ai i anglishtes, mund të vështrohet në disa kahe: sipas shtresave e grupimeve leksiko-semantike të fjalëve, sipas funksionit e vlerës së njërive leksikore e semantike, sipas proceseve dhe lëvizjeve që ndodhin, sipas llojit të ndryshimeve e zhvillimeve të brendshme, sipas marrëdhënieve dhe lidhjeve të fjalëve etj.

Në këtë punim të shkurtër jemi ndalur te *Vargu folje - emër veprimi - emër vepruesi - mbiemër prejpjesor në shqipe dhe në anglishte*, një varg paradigmatic fjalëformues, që, në pamje të parë, të çon në dy fusha studimi: në *morfologji*, sepse brenda vargut kemi pjesë të përcaktuara të ligjëratës dhe procese të nënkuptuara fjalëformimi; në *leksikologji dhe semantikë*, sepse janë disiplina të cilave u intereson njësia e re leksikore që krijohet, kryesisht me përmbajtjen e re që sjell në gjuhë. Njësitë që bëjnë pjesë në këtë varg, kanë lidhje fjalëformimi të drejtpërdrejtë me foljen (si temë fjalëformuese), nga motivohen semantikisht a morfematikisht. Në këtë pikë, bëhet ndërthurja ndërdisiplinore dhe ne do të shtjellojmë lëndë nga të dyja gjuhët pa rënë ndaras në *morfologji të fjalëformimit* dhe në *leksikologji e leksikografi*, por edhe *pa ngatërruar kufijtë e semantikës morfologjike me ata të semantikës leksikore*. Kjo është kushtëzuar nga puna e drejtpërdrejtë mbi fjalorët shpjegues, prej të cilëve kemi nxjerrë lëndën ilustruese.

Formimi i fjalëve në shqipe dhe në anglishte lidhet pazgjidhshmërisht me *mjetet fjalëformuese* si dhe *me marrëdhëniet e semantike* që krijohen ndërmjet njësisë derivuese dhe njësisë së derivuar. Si tema fjalëformuese, foljet mund të jenë të parme dhe jo të parme (të formuara me prejardhje, me konversion, me përbërje etj.).

Duhet të pohojmë se, qoftë në shqipe, qoftë në anglishte, si gjithë sistemin e formimit të fjalëve, edhe atë të vargut *folje - emër veprimi - emër vepruesi - mbiemër prejpjesor* e përshkojnë dy linja kryesore<sup>1</sup>:

a. Linja e parë që nënkupton *madhësitë themelore* që bëjnë vargun e hallkave themelore të formimit të fjalëve, të kalimit nga një si leksikore në tjetrën: *derivuesi – tema fjalëformuese – formanti fjalëformues – derivati*. Në anglishte dhe në shqipe, në vargun në studim, derivues kemi foljen, kurse derivate janë emri i vepruesit, emri i veprimit dhe mbiemri prejpjesor, pra kemi një derivim në skemën *tufë*. Ndaj *vargu folje - emër veprimi - emër vepruesi - mbiemër*

---

<sup>1</sup> Shih më gjerë, J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 233.

## BLERTA XHEKO

*prejppjesor*, më saktë do të ishte i konceptuar si tri vargje të veçanta: *folje - emër veprimi, folje - emër vepruesi, folje - mbiemër prejppjesor*.

Emrat e veprimit dhe emrat e vepruesit në të dyja gjuhët janë formuar përgjithësisht me formante ndajshitesore (prapashtesa), kurse mbiemrat prejppjesorë dalin me një dallim të spikatur strukturor: në shqipe ata janë një paranyjëzim i pjesores, kurse në anglishte mbiemrat e këtij lloji janë të njëjtë (përputhen strukturalisht) me pjesoret (procesi i mbiemërzimit të pjesores).

b. Linja e dytë ndërtohet nga *lidhjet kuptimore* që vendosen ndërmjet *derivuesit* dhe *derivatit*, marrëdhënie ndërmjet njësisë motivuese dhe njësisë së motivuar semantikisht, me mbartjet dhe me ndryshimet e rrafshit kuptimor. Në të dyja gjuhët, njësitë e derivuara (derivatet) janë *emra* që emërtojnë veprime dhe gjendje, *emra* që emërtojnë vepruesin dhe *mbiemra* që tregojnë tiparin e rezultatit të veprimit të shprehur nga folja (*mbiemra prejppjesorë*).

Gjithashtu vargjet paradigmatiche fjalëformuese folje - emër veprimi - emër vepruesi - mbiemër prejppjesor (ose nënvargjet folje - emër veprimi, folje - emër vepruesi, folje - mbiemër prejppjesor), jo gjithmonë janë identike në procese dhe në tipologji në të dyja gjuhët. Fjala vjen, mundësitë dhe fjalët e reja nuk janë të një shkalle. Gjatë procesit të formimit të fjalëve ndeshemi me dy lloj vargjesh, të cilat i ndeshim edhe në vargun, ku ne jemi ndalur:

a. *Vargje të hapura*, që nënkupton mundësinë që ato të shtohen me njësi të reja në mënyrë të papërcaktuar, pra vargje që nuk e ruajnë simetrinë e krijimit të njësisë të reja. Në përgjithësi këtu përfshihen vargjet që motivohen nga një emër. P.sh., në gjuhën shqipe kemi emrin *sy*, i cili motivon jo vetëm disa vargje foljore si *synoj, synues, synim, i synuar, i synueshëm; sythón, sythohet, sythim, i sythuar* etj., por motivon me dhjetëra kompozita, numri i të cilave mund të shtohet potencialisht me njësi të tjera: *sybajáme, sybárdhë, syblértë, sybútë, syçakërr, syçélé (syçéleti), syçeltësi, syçélur, sydhélpër, syégër, syëmbël, syfórtë, syfshéhur, sygácë, sygështénjë, sygrírfshë, sygjárpër, sygjél, syhápët, syhaptësi, syhápur, syjeshíl, syká, sykáltër, sykáth, sykéq, sykeqójë, sykúq, sykullumbri, sylármë, sylarúsh, sylésh, syleshtësi, sylëshúar, symbýllas, symbýllthi, symbýllur, symëllénjë, symëshqérrë, sympréhtë, symprehtësi, sypafjétur, sypámës, sypangínjur, sypangópur, sypatrémbur, sypetrít, sypërdhé, sypërgjúmur, sypërlótur, sypërmbýs (sypërmbýsur), sypërtókë, sypíshë, syplásas, syplásur, syprúsh, syqénëz, syqershí, syrrúsh, syshkëndtjé, syshkrúar, syshqipónjë, syshtrémbër, syullí, syúrët, syvétëm, syvëngër, syvíçe, syxíxë, syzënë, syzgjúar* etj.

b. *Vargje të mbyllura*, që nënkupton se ka një simetri formimi, një numër të njëjtë gjymtyrësh apo fjalësh të motivuara nga tema fjalëformuese. *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006, një vepër me elemente çerdhore, foljet dhe disa njësi të derivuara prej saj i ka parë brenda fjalës titull *folje* dhe aty gjejmë këtë strukturim: *folje, folje në vetvetore, emër i veprimi dhe mbiemri prejppjesor*. Ky parametër kërkon simetri dhe vargje të mbyllur, e thënë ndryshe, dhe atje ku nuk kemi të regjistruar a të pasqyruar një nga këto gjymtyrë të vargut, ajo krijohet ose është në përdorim, edhe pse nuk është në një fjalor.

RRETH VARGUT FOLJE – EMËR VEPRIMI – EMËR VEPRUESI –  
 MBIEMËR PREJPJESOR NË SHQIPE DHE NË ANGLISHTE

Po japim dy shembuj nga *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006, për të parë këtë simetri dhe mbyllje të vargut: **dallgëz/ón** *jokal.*, -ói, -úar 1. bën dallgë, ka dallgë; *dallgëzon deti*; / lëviz si dallgë: *turma dallgëzonte*. 2. *kal.* e bën me dallgë: *era e dallgëzoi grurin*. • **dallgëzóhet** *vetv. v. III*. 1. dallgëzon: *u dallgëzua liqeni*. 2. *fig.* përhapet valë-valë: *kënga dallgëzohej*. / *pës. dallgëzohet v. III*. • **dallgëzim,-i** *m. sh.* -e(t) 1. veprimi sipas foljeve. 2. *kryes. sh.* diçka në trajtën e dallgëve; valëzim: *dallgëzimet e kodrave*. • **dallgëzúar (i, e)** *mb.* 1. që ka dallgë. 2. *fig.* që është si dallgë a që të kujton dallgët, i valëzuar: *sipërfaqe e dallgëzuar*.

**lag** *kal.*, -a, -ur 1. i hedh ujë, e spërkat; e zhyt diçka në ujë për ta zbutur, për ta regjur etj.; e njom; *kund. thaj*; ter: *e lagu shiu*; *lag pambukun me jod (me alkool)*. 2. *v. III* e prek drejtpërdrejt, puqet me të (për ujërat): *deti lag pjesën perëndimore*. 3. pi ose ha fare pak, sa për të njomur gojën: *lagëm gojën me qershi*. 4. *bised. kryes. sh.* pimë raki, verë etj.: *sa lagu buzët*; *do ta lagim sonte*. • **lágem** *vetv. e lag<sub>1</sub>*: *u lag i tëri*; *iu lag këmisha*; *na u lag edhe gjuha (fig.)* u lagëm që nga koka deri te këmbët (nga shiu i madh). / *pës. lágem*. • **lági/e,-a** *f. sh.* -e(t) veprimi sipas foljeve. • **lágur (i, e)** *mb.*, edhe si *em.*, që është lagur: *me flokë të lagur*; *i laguri nga shiu s'trembet nga breshri (ff. u.)*. 2. *bised. i* ujitur: *kopsht i lagur*. ★*lagu sot e rruhu mot duke e zvarritur punën për një kohë shumë të gjatë.*

Në të dy gjuhët, qoftë në anglishte, qoftë në shqipe, mund të gjejmë të ndërthurura të dy llojet e këtyre vargjeve. P.sh. për foljen *punoj* kemi 4 vargje të mbyllur, si kemi dy vargje të hapur (*punë, punëtor, punonjës etj.*; *punë, punoj, punësoj, ripunoj, përpunoj etj.*)

punë	punëtor	punëtori	
	puno(j)		punim
			punues
			i punuar
			i punueshëm
	punësoj		punësim
			punësues
			i punësuar
			i punësueshëm
		ripunoj	ripunim
			ripunues
			i ripunuar
			i ripunueshëm
		përpunoj	përpunim
			përpunues
			i përpunuar
			i përpunueshëm

Si pikë nistore për procesin fjalëformues në vargun *folje - emër veprimi - emër vepruesi mbiemër prejppjesor* është folja, e cila në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze është njësia leksiko-gramatikore ku sendërtohen e zbulohen, thuajse lehtësisht, të gjitha dukuritë semantike dhe struktura e saj kuptimore ndërthun, në

## BLERTA XHEKO

mënyrë më të plotë e më të qartë se ajo e njërive të tjera emërtuese a e pjesëve të tjera të ligjëratës, tërë zhvillimet e ndryshimet kuptimore, të brendshme e të jashtme, të vetvetishme e të drejtuara, reale e mundësore, që kanë ndodhur në rrjedhë të kohërave në leksikon e shqipes e në përmbajtjen e tij. Kjo lehtëson shumë edhe ndjekjen e ndryshimeve nga njësia derivuese të njësisë e derivuar (qofshin në kuptim kategorial, të veçantë, në elementet stilistikore etj.) Kështu në gjuhën shqipe, ndryshe nga në anglishte, folja kalimtare shfaqet së shumti dhe me formën vetvetore, e cila pranohet si njësi leksikore e mëvetësishme, sepse kjo formë ka zhvillime semantike larguese nga folja në veprorë. Ndaj *emrat e veprimit, emrat e vepruesit dhe mbiemrat prejpjesorë* në shqipe kanë si bazë motivuese semantike të dy temat foljore, një lidhje shumë interesante, por me shumë dukuri.

Duke njohur nga afër çështjet e dukuritë që parashtruar, po japim më poshtë grupet paradigmatiche të fjalëve që organizohen nga *work* dhe *punë* për të treguar mundësitë e mëdha fjalëformuese që kanë anglishtja dhe shqipja për të krijuar vargje shumëdrejtueshe me ndërlikime dhe dukuri nga më interesante:

**Work** v. do job / task 1. to do sth that involves physical or mental effort, especially as part of a job: *I can't work if I'm cold.* \* *I've been working at my assignment all day.* \* *He is working on a new novel.* \* *She's outside, working on the car.* \* *Doctors often work very long hours.*

2. to have a job: *Both my parents work.* \* *She works for an engineering company.* \* *I've always worked in education.* \* *Do you enjoy working with children?* \* *My son is working as a science teacher.*

make effort 3. to make yourself/sb work, especially very hard: *She works herself too hard.*

4. ~ (for sth) to make efforts to achieve sth: *She dedicated her life to working for peace.* \* *The committee is working to get the prisoners freed.* \* *The police and the public need to work together to combat crime.*

manage 5. to manage or operate sth to gain benefit from it: *to work the land* (= grow crops on it, etc.) \* *He works a large area* (= selling a company's goods, etc.). \* (figurative) *She was a skilful speaker who knew how to work a crowd* (= to excite them or make them feel sth strongly).

machine / device 6. to function; to operate: *The phone isn't working.* \* *It works by electricity.* \* *Are they any closer to understanding how the brain works?*

7. to make a machine, device, etc. operate: *Do you know how to work the coffee machine?* \* *The machine is worked by wind power.*

have result / effect 8. ~ (on sb/sth) to have the result or effect that you want: *The pills the doctor gave me aren't working.* \* *My plan worked, and I got them to agree.* \* *His charm doesn't work on me* (= does not affect or impress me).

9. to have a particular effect: Your age can work against you in this job. \* *Speaking Italian should work in his favour.*

10. to cause or produce sth as a result of effort: *You can work miracles with very little money if you follow our home decoration tips.*

RRETH VARGUT FOLJE – EMËR VEPRIMI – EMËR VEPRUESI –  
MBIEMËR PREJPJESOR NË SHQIPE DHE NË ANGLISHTE

---

use material 11. ~ sth (into sth) to make a material into a particular shape or form by pressing, stretching, hitting it, etc: *to work clay / dough* \* *to work gold / iron* \* *to work the mixture into a paste.*

12. ~ (in / with sth) (of an artist, etc.) to use a particular material to produce a picture or other item: *an artist working in oils* \* *a craftsman working with wool*

of part of face / body 13. (written) to move violently: *He stared at me in horror, his mouth working.*

move gradually 14. to move or pass to a particular place or state, usually gradually: *It will take a while for the drug to work out of your system.* \* (figurative) *He worked his way to the top of his profession.* \* *I was tied up, but managed to work myself free.* \* *The screw had worked loose.*

IDIOMS Most idioms containing work are at the entries for the *n.s* and *adj.s* in the idioms, for example *work your fingers to the bone* is at finger; *work it / things (informal)* to arrange sth in a particular way, especially by being clever: *Can you work it so that we get free tickets?*

PHRASAL VERBS *work around / round to sth/sb* to gradually turn a conversation towards a particular topic, subject, etc: *It was some time before he worked around to what he really wanted to say.*; *work sth in / work sth into sth* 1. to try to include sth: *Can't you work a few more jokes into your speech?* 2. to add one substance to another and mix them together: *Gradually work in the butter.*; *work sth↔off* 1. to get rid of sth, especially a strong feeling, by using physical effort: *She worked off her anger by going for a walk.* 2. to earn money in order to be able to pay a debt: *They had a large bank loan to work off.*; *work out* 1. to train the body by physical exercise: I work out regularly to keep fit. 2. to develop in a successful way: *My first job didn't work out.* \* *Things have worked out quite well for us.*; *work out (at sth)* if sth works out at sth, you calculate that it will be a particular amount: *It'll work out cheaper to travel by bus.*; *work sb↔out* to understand sb's character: I've never been able to work her out.; *work sth↔out* 1. to calculate sth: *to work out the answer* 2. to find the answer to sth; to solve sth: to work out a problem / puzzle / code \* *Can you work out what these squiggles mean?* \* I couldn't work out where the music was coming from. 3. to plan or think of sth: *I've worked out a new way of doing it.* 4. [usually passive] to remove all the coal, minerals, etc. from a mine over a period of time: *a worked-out silver mine*; *work sb↔over (slang)* to attack sb and hit them, for example to make them give you information; *work to sth* to follow a plan, timetable, etc: *to work to a budget* \* *We're working to a very tight deadline (= we have little time in which to do the work).*; *work towards sth* to try to reach or achieve a goal; *work sth↔up* to develop or improve sth with some effort: *I can't work up any enthusiasm for his idea.* \* *She went for a long walk to work up an appetite.*; *work sb / yourself up (into sth)* to make sb/yourself reach a state of great excitement, anger, etc: *Don't work yourself up into a state about it. It isn't worth it.* \* *I can't get worked up about cars.* \* *What are you so worked up about?;* *work sth up into sth* to bring sth

## BLERTA XHEKO

---

to a more complete or more satisfactory state: *I'm working my notes up into a dissertation.*; *work up to sth* to develop or move gradually towards sth, usually sth more exciting or extreme: *The music worked up to a rousing finale.* \* *I began by jogging in the park and worked up to running 5 miles a day.*

**worker** *n.* 1. (often in compounds) a person who works, especially one who does a particular kind of work: *farm / factory / office workers* \* *rescue / aid / research workers* \* *temporary / part-time / casual workers* \* *manual / skilled / unskilled workers*. See also *guestworker, socialworker*

2. a person who is employed to do physical work rather than organizing things or managing people: *Conflict between employers and workers intensified and the number of strikes rose.* \* *talks between workers and management* \* *profit-sharing and worker participation in decision-making*

3. (usually after an *adj.*) a person who works hard or who works in a particular way: *a hard / fast / quick worker*

4. a female bee that helps do the work of the group of bees but does not reproduce.

**work experience** *n.* 1. the work or jobs that you have done in your life so far: *The opportunities available will depend on your previous work experience and qualifications.*

2. a period of time that a young person, especially a student, spends working in a company as a form of training

**working** *n.* 1. ~ (of sth) the way in which a machine, a system, an organization, etc. works: an introduction to the workings of Congress \* the workings of the human mind \* the machine's inner workings

2. the parts of a mine or *quarry* where coal, metal, stone, etc. is or has been dug from the ground: A pump was used to remove water from the old workings.

**working** *adj.* [only before *n.*] 1. having a job for which you are paid: *the working population* \* *a working wife / mother*. See also *hard-working*.

2. having a job that involves hard physical work rather than office work, studying, etc: *a working man* \* *a working men's club*.

3. connected with your job and the time you spend doing it: *long working hours* \* *poor working conditions* \* *I have a good working relationship with my boss.* \* *She spent most of her working life as a teacher.* \* *recent changes in working practices*

4. a working breakfast or lunch is one at which you discuss business

5. used as a basis for work, discussion, etc. but likely to be changed or improved in the future: a working hypothesis / theory \* Have you decided on a working title for your thesis yet?

6. if you have a working knowledge of sth, you can use it at a basic level

7. the working parts of a machine are the parts that move in order to make it function

RRETH VARGUT FOLJE – EMËR VEPRIMI – EMËR VEPRUESI –  
MBIEMËR PREJPJESOR NË SHQIPE DHE NË ANGLISHTE

8. a working *majority* is a small *majority* that is enough to enable a government to win votes in parliament and make new laws

Tek kjo pasqyrë njësisht që lidhen me foljen *work* gjejmë një grup paradigmatic që përfshin me dhjetëra njësi shënuese - fjalë, me dhjetëra idioma dhe shprehje foljore; aty gjejmë mënyrat kryesore të formimit të fjalëve që nga derivacioni, përbërja, apo idiomatizimi i sintagmave; aty mund të bëjmë analiza morfologjike, por dhe semantike e stilistikore.

E njëjta pamje, por me veçoritë që e dallojnë morfologjinë, leksikologjinë dhe semantikën e shqipes, shfaqet pasqyra e grupit paradigmatic e foljes *punoj* në një fjalor të shqipes standarde, në *Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006*:

**pun/ó**j *jokal.*, -óva, -úar 1. edhe *kal.*, bëj një punë duke përdorur forcën e krahut e të mendjes dhe vegla e mjete për të prodhuar a për të krijuar diçka, për të ndërtuar etj.: *punon në uzinë (në arë, në minierë, në ndërtim); punon në arsim (në tregti); punon me këmbëngulje (me mish e me shpirt, me ndërgjegje, me cilësi); punoj tokën* lëvroj tokën; *punon drurin (hekurin, leshin); punon triko (çorape); kush s'punon, dheut i rëndon (fj. u.)*. 2. ushtroj një mjeshteri a një profesion të caktuar, merrem rregullisht me një veprimtari të caktuar: *punoj si mësues (si agronom, si murator); punoj në tezgjah*. 3. edhe *fig.*, veproj a sillem në një mënyrë të caktuar: *punon me mend në kokë; ka punuar pas shpine (nën rrogoz)*. 4. v. *III* zhvillon veprimtarinë e vet, është i hapur dhe kryen shërbime (për një ndërmarrje, për një institucion, për një dyqan etj.); funksionon: *biblioteka punon gjithë ditën; institucionet nuk punojnë të dielën*. 5. jam i aftë për punë; v. *III* është në gjendje pune; e kryen punën e vet; funksionon: *është i sëmurë e s'punon dot; makina (ora) punon në rregull; s'i punoi pushka* nuk i shkrep; *i punon zemra si sahat; s'më punojnë këmbët (gjunjët)* nuk eci dot; *s'më punojnë sytë* shikoj pak a nuk shoh fare; *s'më punojnë duart* s'jam më i zoti për punë; *s'më bëhet për një punë; i punon mendja për shumë gjëra* mendon a i vete mendja për shumë gjëra. 6. bëj punë edukuese e sqaruese për ta bindur dikë, për ta ngritur nga ana arsimore e kulturore etj.: *punon shumë me fëmijët*. 7. v. *III* më vete mbarë, më ecën; vepron: *i punoi fati; koha punon për ne*. 8. v. *III* mbledh qelb, nuk është mbyllur ende: *punon plaga*. 9. edhe *kal.*, *bised.* e përdor për të kaluar në të, e rrah (një rrugë); v. *III* shkon e vjen, kalon; përdoret: *punonin rrugën e Dibrës; këtej punojnë makina çdo ditë; rruga e vjetër nuk punon më*. 10. *kal.* vë në lëvizje a në veprim; drejtoj një mjet etj.; përdor: *punonte rremat; e punonte shpatën me lehtësi; punon taksinë*. 11. e përpunoj, e përmirësoj, e përsos: *punon gjuhën (stilin, vargun)*. 12. *kal. fig. bised.* i bëj dikujt diçka të keqe; ia hedh: *i punoi gjithë të zezat (qindin); i punoi një rreng (një hile); ia punoi prapa krahëve. / pës. punóhet v. III. • puním,-i m. sh. -e(t)* 1. veprimi sipas foljes: *punimi i mëndafshit (i drurit, i hekurit, i bulmetit)*. 2. puna që kryen një mekanizëm, një organ etj.; funksionim; veprimtari: *punimi i tornos; punimi i zemrës (i muskujve)*. 3. lloj i caktuar pune; ajo që prodhon a që bën dikush: *punime përgatitore (ndihmëse); punim shkencor (diplome); punime druri (balte, kashte)*. 4. *sh.* veprimtaria që kryhet gjatë një mbledhjeje, një konference etj.: *punimet e kongresit (e simpoziumit)*. • **punúar (i, e) mb.** 1. që

## BLERTA XHEKO

është punuar a që është përpunuar: *tokë e punuar* tokë e lëvruar; *lëkurë e punuar*; *dru i punuar*; *gjuhë (vepër) e punuar*; *stil (varg) i punuar*. 2. *bised.* i përdorur (për veglat); i rrahur (për rrugët).

*punónjës,-i m. sh. -(it)*, edhe si *em.*, ai që punon në një institucion, në një ndërmarrje etj.: *punonjës shkencor*; *punonjësit e arsimit (e shkencës, e kulturës)*; *punonjësit e prodhimit*; *masat punonjëse*. • *fem. -e, -ja sh. -e(t)*.

*punúes,-e mb.* që shërben për të kryer një punë: *makinë punuese*; *aftësia punuese*.

Në gjuhën shqipe na tërheq vëmendjen dukuria se kemi shumë shpesh simetri fjalëformuese për llojin e vargut që kemi marrë në shqyrtim. Më sipër u ndalëm për foljen *punoj* që është formuar nga *punë* dhe për foljet *punësoj*, *ripunoj*, *përpunoj* të krijuara nga vetë folja *punoj*. Në shqipe kemi vargjet e plota: *puno(j) - punim - punues - i punuar*; *punësoj - punësim - punësues - i punësuar*; *ripunoj - ripunim - ripunues - i ripunuar*; *përpunoj - përpunim - përpunues - i përpunuar* etj.

Kurse në anglishte kemi një pamje tjetër: nuk kemi simetrinë e formimeve dhe plotësimin e vargjeve në mënyrë sistematike. Kjo nuk është mangësi, sepse anglishtja është gjuhë shumë e pasur me njësi emërtuese. Shqipja ka shumë vargje të tilla simetrike, sepse ka një leksik relativisht të ri dhe te vargu *folje - emër veprimi - emër vepruesi - mbiemër prejppjesor*, nga katër njësi tri, *emër veprimi, emër vepruesi, mbiemër prejppjesor*, janë njësi të leksikut abstrakt që së shumti kanë zënë vend dhjetëvjetëshat e fundit, apo po krijohen me shpejtësi dhe me frytshmëri. Një nga arsytet e formimit është se është shtuar në skajshmëri bota nocionore e shqiptarëve dhe pa tjetër kërkohet dhe krijimi i njëjve emërtuese. Gjithashtu dhe përballja me gjuhët e tjera, si anglishtja, e kërkon këtë si domosdoshmëri për të realizuar këtë përballje në të gjitha nënsistemet, por sidomos në atë leksikor.

Anglishtja shpesh nuk e ka simetrinë fjalëformuese të shqipes, sepse ka shumë fjalë të krijuara në shekuj me mënyra të ndryshme, pra nuk e ka ndier *domosdoshmërinë e plotësimin të vargut me ndajshesave të specializuara* dhe plotësimin e hapësirave të zbrazëta brenda simetrive të vargjeve paradigmatiske në studim. Specializimi kuptimor i ndajshesave është një nga dukuritë që sot po zë vend gjithnjë e më shumë në studimet semantike. Karakteristikë semantike themelore e fjalëve të prejardhura është se ato, si jemi shprehur dhe më parë, motivohen nëpërmjet temave fjalëformuese dhe formanteve fjalëformuese. Zbulimi i i lidhjeve të prejardhjes në vargjet *folje - emër veprimi, folje - emër vepruesi, folje - mbiemër prejppjesor* është në fund të fundit motivim semantik për njësinë e sapokrijuar nga folja. Prof. J. Thomai thekson se “specializimi i ndajshesave në gjuhën shqipe përbën një faktor të rëndësishëm për krijimin e gjedheve semantike në formimin e fjalëve të prejardhura dhe përgjithësisht për formime kategoriale (në klasa të mëdha fjalësh). Specializimi i ndajshesave bëhet kryesisht, kur ato dalin shpesh me tema të ndryshme, por me vlerë modifikuese të njëjtë që është në radhë të parë specializim semantik.”<sup>2</sup>

<sup>2</sup> J. Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 285 – 286.

RRETH VARGUT FOLJE – EMËR VEPRIMI – EMËR VEPRUESI –  
MBIEMËR PREJPJESOR NË SHQIPE DHE NË ANGLISHTE

---

Si në anglishte, ashtu dhe në shqipe, kemi ndajshitesa të specializuara.

a. Në gjuhën shqipe kemi këto prapashtesa të specializuara:

-*im* / -*je*, të cilat formojnë emra veprimi nga tema foljore;

- (*ë*)*s* e cila formon emra vepruesi nga tema foljore. Këtu duhet të ripohojmë se me anën e kësaj prapashtese formohen mbiemra po me këtë kuptim. Klasa e emrave të vepruesit të formuar me këtë ndajshitesë në shqipe ndahet në dy grupe të mëdha, në grupin e njësive që kanë ardhur nga substantivimi i mbiemrave dhe grupi i emrave që janë formuar drejtpërdrejt nga folja.

- Me vlerën e formantit fjalëformues në shqipe shfaqet dhe nyja e përparme, e cila kthen pjesoret e foljeve në mbiemra prejpjesorë.<sup>3</sup>

b. Në anglishte kemi një grup më të madh prapashtesash, që realizojnë derivacionin nga folja tek njësitë që kemi në shqyrtim. Këtu do të veçonim ato që janë më kryesoret:

1. -*ing*, që krijon emra veprimi prej temash foljore (si *modeling* etj.). Kjo prapashtesë është polisemike<sup>4</sup>, sepse formon dhe emra veprimi, dhe një grup shumë të madh mbiemrash me kuptim vepruesi, të barasvlershëm shpesh në shqipe me mbiemrat me -(*ë*)*s*.<sup>5</sup>

-*ation* / -*ion*, si *adjure* – *adjuration*, *concoct* – *concoction*, *confuse* – *confusion*, *confess* – *confession* etj.

-*ment*, si *adjust* – *adjustment* etj.

2. Prapashtesa që krijojnë emra vepruesi nga folje:

- *er*, si *knocker*, *dissipater*, *murderer*, *runner* etj.

- *or*, si *oppressor*, *persecutor* etj.

b. 3. Prapashtesat që formojnë pjesoret pësore të së shkuarës, të cilat funksionojnë dhe si mbiemra prejpjesorë. Këtu gjithashtu kemi dy grupe të mëdha: - mbiemrat e krijuar me morfemën -*ed*, që zakonisht vijnë nga folje me zgjedhim të rregullt, si *dilapidated*, *forked*, *interrelated* etj.

- mbiemrat të krijuar nga pjesoret pësore të së shkuarës të foljeve të parregullta, si *broken*, *drunk* etj.

Si përfundim, dukuritë që u vërejtën në vargun *folje - emër veprimi - emër vepruesi - mbiemër prejpjesor* në shqipe dhe anglishte tregojnë se në të dyja gjuhët, edhe pse me dallime strukturore të theksuara (gjuha shqipe është gjuhë sintetiko-analitike, kurse gjuha angleze është gjuhë analitiko-sintetike) veçoritë e formimit morfematik dhe të motivimit semantik kanë gati veçori të përbashkëta, duke shpërfaqur kështu tipologji të njëjtë. Kjo lehtëson edhe procesin fjalëformues të shqipes për t'iu përgjigjur sa më shpejt dhe sa më saktë shkencërisht trysnisë leksikore të anglishtes, për të mënjeluar fjalën e huaj e për të krijuar fjalën shqipe.

---

<sup>3</sup> V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f.

<sup>4</sup> Shih më gjerë *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 65.

<sup>5</sup> Shih më lart, te folja *work* dhe te mbiemri *working*.